



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË KUVENDEVE KOMUNALE
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Prill, 2010

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

Hyrje

Qëllimi i raportit

Konstituimi i Kuvendit të Komunës

- Mbledhja inauguruese
- Betimi i anëtarëve
- Numri dhe zgjedhja e anëtarëve të kuvendit (përkatësia etnike, gjinore)
- Zgjedhja e kryesuesit
- Zëvendëskryesuesi i komuniteteve
- Komitetet obligative
- Komitetet tjera
- Komitetet konsultative
- Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
- Mbledhjet e kuvendit të komunës

Ekzekutivi

- Zgjedhja e kryetarit të komunës
- Betimi
- Nënkyetari i komunës
- Nënkyetari i komunës për komunitete
- Drejtoritë

AKTIVITETET E KOMUNAVE

Shkeljet ligjore të evidentuara nga MAPL

Konkluzionet

Rekomandimet

Hyrje

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës të Republikës së Kosovës është rregulluar statusi juridik i pushtetit lokal. Komunave, si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale, iu është njohur shkallë e lartë e vetëqeverisjes, e cila duhet të udhëhiqet nga parimet kushtetuese, të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale si dhe në përputhje me parimet e konventave të tjera, të cilat janë të parapara me Kushtetutë. Vetëqeverisja lokale garantohet me Kushtetutë - aktin më të lartë juridik dhe po ashtu me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, si ligj bazik, i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e komunave.

Misioni i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është avancimi i qeverisjes lokale, të bazuar mbi parime të transparencës, efikasitetit, efektivitetit, në ofrimin e shërbimeve efikase, pa diskriminim dhe sa më afër qytetarëve.

Në bazë të mandatit që ka Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, obligohet të mbikëqyrë ligjshmërinë e veprimeve që ndërmerren komuna, në mënyrë që ato të mos bien ndesh me LVL-në, ligje të tjera dhe të mos cenojnë të drejtat e qytetarëve. Me qëllim të mbështetjes së komunave gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, MAPL, gjegjësisht Divizioni i Monitorimit në kuadër të Departamentit për Vetëqeverisje Lokale, vazhdimisht monitoron seancat e kuvendeve komunale. Në këtë drejtim, përveç monitorimit, si mekanizëm për evidencimin e shkeljeve eventuale nga ana e komunave gjatë nxjerrjes së akteve normative komunale apo miratimit të vendimeve, Divizioni i Monitorimit adreson shkeljet në Departamentin Ligjor të MAPL-së, për të bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së këtyre akteve.

Raporti që po prezantojmë pasqyron funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës që nga përfundimi i zgjedhjeve lokale, deri në mars të vitit 2010.

Qëllimi

Qëllimi i raportit ka të bëjë me pasqyrimin e punës dhe të aktiviteteve të ndërmarra nga komunat e Republikës së Kosovës, pas përfundimit dhe certifikimit të zgjedhjeve, të mbajtura në nëntor të vitit 2009. Duke pasur parasysh se pas përfundimit të këtyre zgjedhjeve, ka ndryshuar përbërja e kuvendeve komunale si dhe ekzekutivit, ky proces është përcjell me shumë kujdes nga ana e MAPL-së. Si rezultat i kësaj, në këtë raport ofrohen të dhëna të sakta lidhur me procedurat, të cilat i kanë paraprirë konstituimit të kuvendeve dhe qeverive komunale. Zyrtarët e MAPL-së, përkatësisht Divizionit të Monitorimit, në vazhdimësi marrin pjesë në seancat e rregullta të kuvendeve të komunave, duke evidencuar ecurinë e punës së kuvendeve komunale në kontekst të zbatimit të drejtë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

KONSTITUIMI I KUVENDEVE KOMUNALE

Mbledhja inauguruese

Sipas të dhënave të prezantuara në raport, rezulton se në 33 komuna, pas përfundimit dhe certifikimit të rezultateve zgjedhore, seancat inauguruese janë konvokuar në pajtim me nenin 42 të LVL-së.

Që të gjitha komunat kanë mbajtur me kohë mbledhjen inauguruese. Në pajtim me nenin 42 të LVL-së, mbledhjet janë thirr nga kryetari i komunës i komunës, brenda afatit ligjor, të cilat në vijim janë kryesuar nga anëtari më i vjetër i kuvendit komunal deri në zgjedhjen e kryesuesit të ri. Këtu duhet përjashtuar Komunën e Malishevës, e cila nuk ka respektuar pikën 5 të nenit 42 të LVL-së. Para zgjedhjes së kryesuesit të kuvendit në këtë komunë, mbledhjet nuk janë udhëhequr nga anëtari më i vjetër siç parasheh LVL, mirëpo janë udhëhequr nga kryetari i Komunës.

Betimi i anëtarëve të kuvendit

Betimi i anëtarëve të kuvendeve të komunave të Republikës së Kosovës është bërë në përputhje me nenin 35. 4 të LVL-së, me përjashtim të komunës së Gjakovës dhe Malishevës. Kjo si rezultat i mosrespektimit të afatit ligjor 1 mujor për dhënien e betimit, siç e parasheh neni 35 .5 i LVL-së. Me qëllim të dhënies së mundësisë për të qenë pjesë e kuvendit komunal, në komunat ku nuk është respektuar afati ligjor për dhënie të betimit, MAPL ka dërguar një shkresë, në të cilën ka përcaktuar një afat ligjor për dhënien e betimit. Si rezultat i kësaj, pavarësisht shkeljeve apo veprimeve që janë bërë nga anëtarët e kuvendeve të komunave përkitazi me dhënien e betimit, konkludojmë se që të gjithë anëtarët e kuvendeve të komunave ku nuk është dhënë betimi, tanimë kanë plotësuar këtë kusht.

Zgjedhja e kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit për komunitete

Bazuar në nenin 41 të LVL-së i cili rregullon procedurën e zgjedhjes së kryesuesit të kuvendit të komunës, të gjitha komunat kanë zgjedhur kryesuesin e kuvendit në përputhje me të gjithë paragrafët e këtij neni.

Për dallim nga komunat tjera, Komuna e Gjakovës dhe Novobërdës, kryesuesin e kuvendit të komunës e kanë zgjedhur nga radhët e përkatësisë gjinore femërore, që do të thotë se është në përputhje me politikat e integritetit të komunitetit femëror në proceset vendimmarrëse.

Zgjedhja e zëvendë kryesuesit për komunitete

Zëvendëskryesues të kuvendit për komunitete kanë zgjedhur këto komuna: Gjakova, Shtërpca, Mitrovica, Peja, Prishtina, Obiliqi, Novobërda, Dragashi, Prizreni, Kamenica. Në komunat tjera nuk është zgjedhur zëvendëskryesuesi për komunitete, pasi që në këto komuna përqindja e komuniteteve pakicë nuk arrin deri në 10% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, siç parasheh neni 54.1 i LVL-së.

Komuna e Fushë Kosovës edhe pse ka afër 10% të komuniteteve pakicë, ende nuk e ka zgjedhur zëvendëskryesuesin e komunës për komunitete.

Në bazë të raporteve të monitorimit, MAPL konstaton se, jo në të gjitha komunat janë respektuar procedurat për zgjedhjen e zëvendëskryesuesve për komunitete. Më konkretisht, Komuna e Vitisë dhe Ferizajt, zëvendëskryesuesin e komunës për komunitete e kanë zgjedhur jo nga radhët e komunitetit pakicë, siç parashihet me nenin 54.1 të LVL-së, por nga radhët e komunitetit shumicë.

Meqenëse ende nuk është bërë regjistrimi i popullsisë dhe nuk ekzistojnë të dhëna të sakta mbi numrin e banorëve të të gjitha komuniteteve në Kosovë, MAPL ka hasur në vështirësi sa i përket zbatimit të ligjshmërisë së vendimeve që kanë të bëjnë me zgjedhjen e zëvendëskryesuesit për komunitete.

FUNKSIONIMI I KOMITETEVE TË KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Komitetet e obligueshme

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (neni 51), Kuvendet Komunale themelojnë Komitetin për politikë dhe financa si dhe Komitetin për komunitete si komitete të përhershme.

Me përjashtim të komunave Gjilan, Prizren, Z. Potok dhe Zveqan (për këto dy të fundit nuk kemi informacione), të gjitha komunat tjera kanë themeluar komitetet obligative. Kuvendi i Komunës së Prizrenit dhe Gjilanit nuk ka themeluar asnjërin nga komitetet e obligueshme, ndërkaq komuna e Glllogocit (meqenëse nuk ka komunitete pakicë) dhe Komuna e Mamushës nuk kanë themeluar Komitetin për Komunitete.

Në të gjitha komunat ku janë formuar këto komitete, përbërja e tyre reflekton përfaqësimin e të gjitha subjekteve politike në kuvend, duke respektuar renditjen e subjekteve me numër më të madh të ulëseve në kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik të komunës.

Në komunat ku është themeluar Komiteti për Politikë dhe Financa, mbledhjet e këtij të fundit janë mbajtur si më poshtë: nga një mbledhje kanë mbajtur komuna e Ferizajt, Junikut, Klinës, Pejës, Rahovecit dhe Shtërpçës; nga dy mbledhje kanë mbajtur komuna e Glllogocit, Gjakovës, Deçanit, Kaçanikut, Kamenicës, Malishevës, Mitrovicës, Novobërdës, Fushë Kosovës, Prishtinës, Shtimes, Suharekës dhe Vushtrrisë, ndërsa në komunat Hani Elezit, Skenderaj dhe Viti janë mbajtur nga 3 sosh. Komunat në të cilat ky komitet nuk ka mbajtur asnjë mbledhje janë: Dragashi, Istogu, Lipjani, Mamusha, Obiliqi dhe Podujeva.

Komiteti për Komunitete

Komiteti për Komunitete, është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së veprimeve të autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale për t'u siguruar se të drejtat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Në komunat ku është themeluar Komiteti për Komunitete, mbledhjet e këtij të fundit janë mbajtur si në vijim:

Nga një mbledhje kanë mbajtur komuna e Ferizajt, Istogut, Klinës, Mitrovicës, Shtimes, Shtërpçës, Suharekës, Vitisë dhe Vushtrrisë. Nga dy mbledhje kanë mbajtur komuna e Deçanit, Fushë Kosovës dhe Prishtinës, ndërsa komunat Dragash, Junik, Hani Elezit, Kaçanik, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Novobërd, Oiliq, Pejë, Podujevë dhe Rahovec nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje.

Më poshtë, në formë tabelare janë paraqitur të dhënat për numrin e mbledhjeve të komiteteve obligative.

	Komunat	KPF	KK	Gjithsej
1	Deçan	2	2	4
2	Dragash			
3	Ferizaj	1	1	2
4	F.Kosovë	2	2	4
5	Drenas	2		2
6	Gjakovë	2		2
7	Gjilan			
8	H.Elezit	3		3
9	Istog		1	1
10	Junik	1		1
11	Kaçanik	2		2
12	Kamenicë	2		2
13	Klinë	1	1	2
14	Lipjan			
15	Malishevë	2		2
16	Mamushë			
17	Mitrovicë	2	1	3
18	N.Bërd	2		2
19	Obiliq			
20	Pejë	1		1
21	Podujevë			
22	Prishtinë	2	2	4
23	Prizren			
24	Rahovec	1		1
25	Skënderaj	3		3
26	Suharekë	2	1	3
27	Shtërpcë	1	1	2
28	Shtime	2	1	3
29	Viti	3	1	4
30	Vushtrri	2	1	3
31	Z.Potok			
32	Leposaviq			
33	Zveçan			
34	Klllokot			
35	Ranillug			
36	Graçanicë			
		41	15	56

Tabela 1. Dhënat për numrin e mbledhjeve të komiteteve obligative

Nga tabela 1, shihet se në komunat ku janë themeluar Komitetet obligative, janë mbajtur 41 mbledhje të Komitetit për politikë dhe financa dhe 15 mbledhje të Komitetit për komunitete. Gjithsej janë mbajtur 56 mbledhje.

Komitetet tjera

Përveç komiteteve të obligueshme, komunat themelojnë edhe komitete tjera, për të cilat konsiderojnë se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tyre. Gjatë periudhës janar – mars 2010 disa nga komunat kanë themeluar komitete të tjera. Një pjesë e komunave janë në proces të themelimit të këtyre komiteteve, mirëpo shumica prej tyre nuk kanë ndërmarrë ndonjë hap konkret në këtë drejtim.

Komunat të cilat kanë themeluar komitete të tjera krahas atyre të obligueshme janë: Prishtina (6), Podujeve (4), Ferizaj (6), Fushë Kosova (1), Gjakova (1), Glligoci (4) dhe Mitrovica (3). Pra, siç shihet janë nga 7 komuna janë themeluar gjithsej 25 komitete të tjera.

Komunat të cilat nuk kanë themeluar asnjë komitetet tjetër krahas atyre të obligueshme janë: Gjilani, Hani Elezit, istogu, Kaçaniku, Kamenica, Klina, Lipjani, Malisheva, Mamusha, Novobërda, Obiliqi, Peja, Prizreni, Rahoveci, Shtime, Skenderaj, Shtërpca, Suhareka, Vitia, Vushtrria, Klllokoti, Graçanica, Ranillugu. Duhet shtuar se për komunën e Zubin Potokut dhe Zveqanit nuk kemi informacione.

Komitetet Konsultative

Këto komitete i themelon kuvendi i komunës si komitete këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Me LVL (nenin 73.3) parashihet që anëtarësimi në këto komitete të përbëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.

Sipas raporteve të monitorimit, komunat të cilat kanë themeluar komitete konsultative, me përjashtim të komunës së Pejës, kanë respektuar nenin 73.3 të LVL-së. Komuna e Pejës me rastin e themelimit të komiteteve konsultative ka bërë shkelje të nenit 73.3 të LVL-së, sepse komitetet në fjalë përbëhen nga anëtarë të subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend.

Komunat të cilat kanë themeluar komitete konsultative janë: Ferizaj (6), Hani Elezit (3), Mitrovica (5), Peja (4), Vushtrria (3). Nga kjo rezulton se në 5 komuna janë themeluar gjithsej 18 komitete konsultative.

Komunat të cilat nuk kanë themeluar komitete konsultative janë:

Deçani, Dragashi, Ferizaj, Fushë Kosova, Glligoci, Juniku, Gjakova, Gjilani, istogu, Kaçaniku, Kamenica, Klina, Lipjani, Malisheva, Mamusha, Novobërda, Obiliqi, Prishtina, Podujeva, Prizreni, Rahoveci, Shtimja, Skenderaj, Shtërpca, Suhareka, Vitia, Klllokoti, Graçanica, Ranillugu.

Mbledhjet e kuvendit të komunës

Pas konstituimit dhe funksionalizimit të kuvendeve komunale, të gjitha komunat e Republikës së Kosovës kanë mbajtur seancat e rregullta, duke zhvilluar normalisht veprimtarinë e tyre legislative.

Sipas nenit 43.3 të LVL-së, kuvendi i komunës mbanë së paku dhjetë seanca në vit. Në bazë të raporteve të monitorimit, konstatojmë se pothuajse të gjitha komunat, me kohë kanë mbajtur seancat e rregullta. Këtu duhet përjashtuar komunën e Prizrenit, Lipjanit dhe Gjilanit, të cilat për shkak të përsëritjes së zgjedhjeve nuk kanë mundur të konstituohen dhe të zhvillojnë punën me rregull.

Sa i përket mbarëvajtjes së punës së kuvendit, njoftimit lidhur me kohën e mbajtjes së seancave, pikave të rendit të ditës, shpërndarjes së materialit, si dhe çështjeve tjera të përcaktuara me nenin 43 të LVL-së, nuk është evidentuar ndonjë parregullsi.

Të gjitha mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë transparente për publikun. Në shumicën e komunave, seancat e rregullta të kuvendeve komunale transmetohen direkt në televizionet lokale. Kjo u mundëson qytetarëve informim të duhur lidhur me veprimtarinë dhe vendimet që ndërmarrin komunat në kontekst të realizimit të të drejtave të tyre.

Me qenë se komunat janë të obligueshme që të sigurojnë përkthim simultant gjatë mbajtjes së mbledhjeve, në komunat ku ka komunitete pakicë, një praktikë e tillë respektohet me përpikëri.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat mbi numrin e seancave të rregullta dhe jashtëzakonshme gjatë periudhës janar – mars 2010 , duke përfshirë edhe mbledhjet inauguruese.

	Komunat	Mbledhja inuguruese	Seancat e rregullta	Seancat e jashtëzakonshme	Gjithsej
1	Deçan	1	3		4
2	Dragash	1	2		3
3	Ferizaj	1	2		3
4	F.Kosovë	1	3		4
5	Drenas	1	3		4
6	Gjakovë	1	3		4
7	Gjilan	1	2		3
8	H.Elezit	1	3		4
9	Istog	1	3		4
10	Junik	1	2		3
11	Kaçanik	1	2	1	4
12	Kamenicë	1	2		3
13	Klinë	1	3		4
14	Lipjan	1	2		3
15	Malishevë	1	2	1	4
16	Mamushë	1	3		4
17	Mitrovicë	1	2	1	4
18	N.Bërd	1	3		4
19	Obiliq	1	2		3
20	Pejë	1	3		4
21	Podujevë	1	2		3
22	Prishtinë	1	3		4
23	Prizren	1		1	2
24	Rahovec	1	2		3
25	Skënderaj	1	3		4
26	Suharekë	1	3		4
27	Shtërpcë	1	1	1	3
28	Shtime	1	3		4
29	Viti	1	3		4
30	Vushtrri	1	3		4
31	Z.Potok	/			
32	Leposaviq	/			
33	Zveçan	/			
34	Kllokot	1			1
35	Ranillug	1			1
36	Graçanicë	1			1
		33	73	5	111

Tabela 2. Mbledhjet inauguruese, seancat e rregullta dhe seancat e jashtëzakonshme.

Nga të dhënat e prezantuara në tabelën e sipërme, mund të përfundojmë se: 33 komuna kanë mbajtur me kohë seancën inauguruese. Janë mbajtur 73 seanca të rregullta dhe 5 seanca të jashtëzakonshme. Gjithsej janë mbajtur 111 seanca.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 08/2009 MPB - 02/2009 MAPL, KKSB-ja është trup konsultues për çështjet e sigurisë me përfaqësim të gjerë të të gjitha bashkësive të një komune dhe përfaqësues të shoqërive civile, që në bashkëpunim me Policinë, shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë për bashkësitë.

Në bazë të të dhënave që posedojmë, përveç komunës së Shtërpcës, Prizrenit, Kamenicës, Kllokotit, Ranillugut, Klinës dhe Graçanicës, të gjitha komunat tjera kanë themeluar Këshillin komunal për siguri në bashkësi. Për komunën e Zubin Potokut dhe Zveçanit nuk kemi informacione.

Sipas U.A. të mësipërm, KKSB mbledhet jo më pak se dhjetë herë në vit.

Gjatë këtij tremujori, KKSB ka mbajtur nga një mbledhje në këto komuna: Deçan, Fushë Kosovë, Gjakovë, Kaçanik, Malishevë, Dragash, Ferizaj, Podujevë, Obiliq dhe Suharekë. Nga dy mbledhje janë mbajtur në komunën Hani Elezit dhe Lipjan. Nga tri mbledhje janë mbajtur në Drenas, Skenderaj dhe Vushtrri. Në Komunën e Shtimes dhe të Mitrovicës, KKSB ka mbajtur nga 4 takime, ndërsa në KKSB nuk ka mbajtur asnjë takim në këto komuna: Junik, Istog, Novobërd, Gjilan, Viti, Prishtinë dhe Rahovec.

UDHËHEQËSIA KOMUNALE - EKZEKUTIVI

Krahas konsistimit të kuvendeve komunale, në këtë raport shkurtimisht është paraqitur edhe procesi i formimit të ekzekutivit, si pjesë e pushtetit përgjegjës për administrimin e përgjithshëm të komunës, të bazuar në parimin e ndarjes fleksibile të pushtetit.

Zgjedhja e kryetarit të komunës

Pas përfundimit dhe certifikimit të rezultateve zgjedhore, të gjithë kryetarët e komunave kanë bërë betimin apo deklaratën solemne para anëtarëve të kuvendeve komunale, në përputhje me nenin 57 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Emërimi i nënkryetarit të komunës dhe nënkryetarit të komunës për komunitete

Sipas nenit 60 të LVL-së, në çdo komunë, kryetari i Komunës ka një nënkryetar. Ky i fundit emërohet nga kryetari i Komunës, për një mandat 4 vjeçar, i cili edhe mund ta shkarkoj atë.

Po ashtu, sipas nenit 61 të LVL-së, në komunat ku të paktën 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve jo shumicë, do të kenë një nënkryetar të komunës për komunitete.

Nga kjo rezulton se, komunat ku të paktën 10% e qytetarëve i përkasin komunitetit pakicë, kanë të drejtë të kenë një nënkryetar për komunitete. Në praktikë, kjo nuk është respektuar në komunën e Lipjanit, Prizrenit dhe Pejës. Në komunën Lipjanit është emëruar nënkryetari i dytë i komunës, mirëpo nga komuniteti shumicë. Në Komunën e Pejës është emëruar një nënkryetar shqiptar dhe dy nënkryetar nga komuniteti pakicë. Ndërsa, në Komunën e Prizrenit ka pasur tendencë në krijimin mundësisë për emërimin e nënkryetarit të dytë të komunës po ashtu nga radhët e komunitetit shumicë. Kjo pozitë nuk parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Drejtoritë komunale

Sa i përket administratës komunale, ajo është e organizuar në drejtori. Sipas të dhënave që posedojmë, shumica e komunave kanë pësuar ndryshim të numrit të drejtorive. Pothuajse të gjitha komunat, me rastin e shtimit të numrit të

drejtorive, paraprakisht kanë ndryshuar statutet e tyre, për të pasuar me krijimin e drejtorive të reja. Komuna e Prishtinës ka amandamentuar statutin pas formimit të drejtorive të reja, me arsyetimin se kanë pritur miratimin e Ligjit për Prishtinën në Parlamentin e Kosovës, ndërsa Komuna e Vitisë dhe Lipjanit kanë themeluar drejtori të reja, pa ndryshuar paraprakisht statutin e tyre.

AKTIVITETET E KOMUNAVE

Në vijim është paraqitur raporti mbi funksionimin e kuvendeve komunale për secilën komunë.

Konkretisht, ky raport përfshinë numrin e seancave të Kuvendeve Komunale për tremujorin e parë të këtij viti, funksionimi i komiteteve obligative, funksionimi i komiteteve të tjera, mbajtja e tubimeve publike me qytetarët, numri i kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare, rregulloret e miratuara gjatë kësaj periudhe, vendimet e miratuara gjatë këtij tre mujori etj.

KOMUNA E DEÇANIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Kuvendi i Komunës së Deçanit funksionon konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-40. Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Deçanit ka mbajtur tri seanca të rregullta. Deri më tani nuk është mbajtur asnjë mbledhje e jashtëzakonshme. Të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend marrin pjesë në mënyrë të rregullt në punën e Kuvendit.

Kuvendi i Komunës së Deçanit ka themeluar Komitetet e përhershme, siç parasheh neni 51.1 i LVL-së. Gjatë kësaj periudhe Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 2 mbledhje. Gjithashtu, edhe Komiteti për Komunitete ka realizuar 2 mbledhje.

Kuvendi i Komunës ende nuk ka themeluar Komitete Konsultative, ashtu siç parashihet në nenin 73. 1 i LVL-së, e po ashtu nuk janë themeluar Komitete të tjera të nevojshme për kryerjen e përgjegjësisë të tyre, të parapara me nenin 51.2 të LVL-së.

Kuvendi i Komunës së Deçanit gjatë këtij tremujori nuk ka organizuar ndonjë takim publik me qytetarë, mirëpo në të gjitha takimet e rregullta, qytetarë të interesuar marrin pjesë, duke iu ofruar mundësia që të japin propozime të

ndryshme me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve për problemet me të cilat ata ballafaqohen.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës së Kuvendit dhe Rregulloren për leje për ushtrimin e veprimtarive afariste.

Sa u përket vendimeve, janë miratuar gjithsej 16.

Komuna ka të miratuar Rregulloren për Përdorim të Gjuhëve.

Kuvendi i Komunës ka pranuar kërkesa të ndryshme nga qytetarë, kurse sa u përket peticioneve nuk ka pasur asnjë të tillë. Sipas të dhënave që posedojmë, deri më tani nuk ka pasur asnjë kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare.

Komuna e Deçanit nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me komunat e tjera brenda ose jashtë vendit.

Komuna më parë ka themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB). Tani janë në fazën e ndryshimeve të përbërjes së KKSB-së. Gjatë periudhës janar-mars është mbajtur vetëm një takim i KKSB-së.

KOMUNA E DRAGASHIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Dragashit ka mbajtur tri (3) mbledhje të rregullta, ndërsa mbledhje të jashtëzakonshme nuk ka mbajtur. Gjatë kësaj periudhe Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete nuk kanë mbajtur asnjë takim.

Gjatë këtij tremujori nuk është themeluar ndonjë komitet konsultativ. Po ashtu nuk është organizuar ndonjë tubim publik me qytetarët. Komuna nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me komuna të tjera, fshatra ose vendbanime. Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2010 Kuvendi i Komunës së Dragashit ka miratuar pesë (5) Vendime ndërsa nuk ka miratuar asnjë Rregullore të vetme.

Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare si dhe kërkesa dhe peticione nga qytetarët për Kuvendin e Komunës. Komuna e Dragashit ka të themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, por që gjatë kësaj periudhe nuk ka mbajtur asnjë takim. Komuna ka të miratuar Rregulloren për përdorimin e gjuhëve.

Deri më tani nuk ka pasur raste që ndonjë subjekt politik të mos marrë pjesë në punën e Kuvendit të Komunës, apo raste kur zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, aktet apo vendimet e komunës t'ia paraqes Kuvendit për rishqyrtim sipas nenit 55.3 të LVL.

KOMUNA E FERIZAJT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Ferizajt ka mbajtur dy mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur ndonjë mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe është realizuar një mbledhje e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe një mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Ferizajt nuk ka ngritur Komitete Konsultative por ka themeluar komitete të tjera.

Për periudhën tre mujore të këtij viti, Komuna e Ferizajt nuk ka organizuar tubime publike me qytetarë. Kuvendi i Komunës nuk ka miratuar asnjë rregullore, por ka miratuar 8 vendime

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare apo kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës.

Kuvendi i Komunës ka themeluar edhe Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 2 takime. Po ashtu në këtë komunë nuk ka pasur raste kur zëvendëskryesuesi për komunitete ka paraqitur akte apo vendime kuvendit për rishqyrtim.

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur ndonjë mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar dy mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe dy mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Fushë Kosovës nuk ka themeluar komitete konsultative në përputhje me nenin 73.1 të LVL-së, mirëpo përveç komiteteve të obligueshme ka themeluar Komitetin për ndërmjetësim.

Gjatë këtij tremujori, kjo komunë nuk ka organizuar tubime publike me qytetarë. Gjatë kësaj periudhe Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren për shitjen e banesave në Kompleksin 300. Po ashtu, komuna ka të miratuar Rregulloren për përdorim të gjuhëve. Ndërsa gjithsej janë miratuar dymbëdhjetë vendime.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare apo kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës. Nuk ka pasur raste kur zëvendëskryesuesi për komunitete ka paraqitur akte për rishqyrtim sipas nenit 55.3 të LVL.

Kuvendi i Komunës ka themeluar edhe Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe ka mbajtur një mbledhje gjatë kësaj periudhe.

Po ashtu nuk është lidhur ndonjë marrëveshje me komunat të tjera brenda dhe jashtë vendit, fshatra, vendbanime apo lagje.

KOMUNA E GLOGOCIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Kuvendi i Komunës së Glogocit është funksional dhe gjatë periudhës janar-mars ka mbajtur tri mbledhje të rregullta. Deri më tani nuk është mbajtur ndonjë mbledhje e jashtëzakonshme.

Kuvendi i komunës si komitet obligativ ka themeluar Komitetin për Politikë e Financa i cili ka mbajtur dy mbledhje. Me qenë se në këtë komunë nuk ka komunitete pakicë, nuk është themeluar Komiteti për Komunitete.

Në këtë komunë, nuk është themeluar ndonjë Komitet konsultativ, por janë themeluar komitete tjera funksionale

Kuvendi i Komunës, në periudhën tre mujore, nuk ka mbajtur asnjë tubim publik me qytetarë. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren komunale për gjuhë, si dhe ka miratuar 10 vendime.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Glogocit për periudhën tre mujore ka pranuar dy kërkesa për qasje në dokumente zyrtare. Deri më tani nuk është drejtuar ndonjë kërkesë apo petition për Kuvendin e Komunës. Komuna e Glogocit, nuk ka lidhur marrëveshje me komuna tjera, fshatra ose vendbanime. Në komunën e Glogocit, është krijuar edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, që gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 3 takime. Në këtë komunë nuk ka zëvendëskryesues për komunitete.

KOMUNA E JUNIKUT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Kuvendi i Komunës së Junikut funksionon konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040. Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës ka mbajtur mbledhjen inauguruese dhe tri seanca të rregullta, ndërsa nuk është mbajtur asnjë seancë e jashtëzakonshme. Sa i përket pjesëmarrjes së rregullt në seancë, deri më tani nuk ka pasur rast që ndonjë subjekt politik të mos marr pjesë në punën e Kuvendit.

Kuvendi i Komunës ka themeluar Komitetet e përhershme, mirëpo nuk ka formuar komitete të tjera të parapara me LVL (neni 51.2). Për shkak të vështirësive financiare nuk është formuar ndonjë Komitet Konsultativ.

Gjatë këtij tremujori, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 1 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete nuk ka mbajtur asnjë të tillë.

Janë miratuar gjithsej 12 vendime. Nuk është miratuar asnjë Rregullore, mirëpo është në diskutim publik Draft-rregullorja mbi organizimin e transportit rrugor brenda territorit të komunës së Junikut.

Komuna ka të miratuar Rregulloren për Përdorim të Gjuhëve.

Nga qytetarët nuk ka pasur ndonjë kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare. Gjithashtu, Kuvendit të Komunës nuk i është drejtuar asnjë kërkesa dhe peticion. Komuna e Junikut ka lidhur një Marrëveshje Mirëkuptimi me Komunën e Gjakovës. Me këtë marrëveshje parashihet që Komuna e Gjakovës t'i dalë në ndihmë Komunës së Junikut me kapacitete njerëzore dhe teknike në raste emergjente, për arsye se Njësia e Zjarrfikësve në Junik nuk posedon pajisje të nevojshme teknike.

Komuna e Junikut deri më tani nuk ka bërë ndonjë marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje.

Në këtë komunë është themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi konform U.A 08/2010. Gjatë kësaj periudhe janar-mars, KKSBJ-ja nuk ka mbajtur ndonjë takim.

KOMUNA E GJAKOVËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka mbajtur tri mbledhje të rregullta. Nuk është mbajtur asnjë mbledhje e jashtëzakonshme, ndërsa në janar është mbajtur një takim publik me qytetarë.

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, edhe pse ka pasur disa probleme në lidhje me mospjesmarrjen e rregullt të subjekteve të caktuara politike në punën e Kuvendit, megjithatë është funksional. Në seancën inauguruese dhe seancën e parë të rregullt, subjekti politik i AKR-së nuk ka qenë prezent.

Kuvendi i Komunës ka themeluar Komitetet e përhershme në përputhje me nenin 51.1 të LVL-së. Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë kësaj periudhe ka mbajtur dy mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur një.

Përveç Komiteteve të përhershme, është themeluar edhe Komiteti për Auditim. Ndërkaq, ende nuk është themeluar ndonjë Komitet Konsultativ.

Kuvendi i Komunës gjatë këtij tremujori ka miratuar 10 vendime, ndërsa nuk ka miratuar asnjë rregullore. Komuna ka të miratuar Rregulloren për përdorim të gjuhëve.

Sa i përket rishqyrtimit të vendimeve të Kuvendit të Komunës sipas nenit 55.3. të LVL-së, ka pasur një rast kur zëvendëskryesuesi i Kuvendit ka kërkuar që të bëhet ndryshimi i anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

Komuna nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me komunat e tjera brenda ose jashtë vendit, e gjithashtu nuk ka bërë ndonjë marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje.

Konform Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2010 është themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi. Ky këshill në këtë periudhë ka mbajtur një mbledhje.

Sa u përket kërkesave për qasje në dokumentet zyrtare, nuk ka pasur ndonjë të tillë, ndërsa Kuvendit të Komunës i është drejtuar në kërkesë.

KOMUNA E GJILANIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Kuvendi Komunal i Gjilanit është funksional, mirëpo pas mbajtjes së seancës inauguruese, opozita nuk ka marrë pjesë në dy mbledhje. Kuvendi ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje: seancën inauguruese, 1 mbledhje të jashtëzakonshme dhe 1 të rregullt. Gjatë kësaj periudhe nuk është mbajtur ndonjë tubim publik me qytetarë. Në këtë komunë, Komiteti për Politikë dhe Financa është në fazën e konstituimit, kurse komitetet tjera ende nuk janë formuar. Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka miratuar shtatë vendime, ndërsa ende nuk ka miratuar asnjë rregullore. Komuna nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me komunat brenda dhe jashtë vendit, po ashtu nuk ka lidhur marrëveshje me fshatra e vendbanime.

Në këtë komunë është formuar Këshilli për Siguri në Bashkësi konform Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2010 dhe ka patur një takim. Ankesat dhe petitionet drejtohen në Qendrën për Shërbime të qytetarëve. Komuna ka të miratuar Rregulloren për Gjuhët. Komitete konsultative ende nuk janë formuar.

KOMUNA E HANIT TË ELEZIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit ka mbajtur tri mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur ndonjë mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur dy mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete nuk ka mbajtur asnjë.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Hanit të Elezit ka marrë vendim për themelimin e tri komiteteve konsultative, është shpallur konkursi për zgjedhjen e anëtarëve të këtyre komiteteve por që ende nuk janë funksionalizuar .

Për këtë tre muaj të këtij viti Komuna e Hanit të Elezit nuk ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kjo komunë nuk ka Rregullore komunale për gjuhët. Gjatë kësaj periudhe nuk është miratuar asnjë rregullore, por janë miratuar 11 vendime.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare, si dhe kërkesa e peticione. Komuna ka formuar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Gjatë kësaj periudhe ky këshill ka mbajtur 2 mbledhje. Në këtë komunë zëvendëskryesuesi për komunitete nuk ka pasur raste kur aktet dhe vendimet ti paraqet kuvendit për rishqyrtim.

KOMUNA E ISTOGUT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së istogut ka mbajtur tri (3) mbledhje të rregullta, ndërsa mbledhje të jashtëzakonshme nuk ka mbajtur. Gjatë kësaj periudhe Komitetit për Politikë dhe Financa nuk ka mbajtur asnjë mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur një.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e istogut nuk ka ngritur komitete konsultative. Për këtë tre mujor të këtij viti, kjo Komunë nuk ka organizuar tubim publik me qytetarë. Po ashtu gjatë kësaj periudhe Kuvendi i Komunës nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera apo me fshatra ose vendbanime. Janë miratuar gjithsej pesë vendime, ndërsa nuk është miratuar ndonjë Rregullore.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë periudhës janar-mars 2010 në këtë Komunë nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare apo kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës. Komuna e istogut ka të themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, por që gjatë kësaj periudhe nuk ka mbajtur asnjë takim. Komuna ka të miratuar Rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve.

Vlen të ceket se në këtë komunë nuk ka pasur raste ku ndonjë subjekt politik nuk merr pjesë në punën e kuvendit komunal, apo raste kur zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, aktet apo vendimet e komunës t'ia paraqet kuvendit për rishqyrtim sipas nenit 55.3 të LVL.

KOMUNA E KAÇANIKUT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka mbajtur tri mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur ndonjë mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar dy mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa, ndërsa Komiteti për Komunitete nuk ka mbajtur asnjë.

Sipas informacioneve që ka MAPL komuna e Kaçanikut ende nuk ka formuar komitetet konsultative.

Për tre mujorin e parë të këtij viti Komuna e Kaçanikut nuk ka organizuar tubime publike me qytetarët. Gjatë kësaj periudhe nuk është miratuar ndonjë rregullore, kurse janë miratuar 11 vendime. Kuvendi i Komunës nuk ka miratuar Rregulloren për gjuhët.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Janë adresuar gjithsej 60 kërkesa, e po ashtu ka pasur edhe një peticione nga qytetarët e Komunës.

Kjo komunë nuk ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me komunat e tjera brenda vendit dhe jashtë, por ka lidhur marrëveshje me fshatra, vendbanime dhe lagje për bashkë financim të projekteve.

Kjo komunë nuk ka pranuar kërkesë nga zëvendëskryesuesi për komunitete për rishqyrtimin e akteve apo vendimeve sipas nenit 55.3 të LVL.

Komuna ka themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili gjatë kësaj periudhe ka mbajtur një mbledhje.

KOMUNA E KAMENICËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Kuvendi i Komunës së Kamenicës është funksional dhe që të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në kuvend, marrin pjesë rregullisht në mbledhje. Kuvendi i komunës ka mbajtur Ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje. Seancën inauguruese e ka mbajtur me datë 08.01.2010, seancën parë të rregullt më 16.02.2010, kurse seancën e dytë të rregullt e ka mbajtur me datë 26.03.2010. Gjatë kësaj periudhe nuk është mbajtur ndonjë mbledhje e jashtëzakonshme. Po ashtu nuk është mbajtur asnjë tubim publik me qytetarë. Deri më tani ende nuk është miratuar asnjë rregullore, kurse janë miratuar gjithsej 18 vendime. Nuk ka pasur raste kur zëvendëskryesuesi për komuniteteka të paraqes për rishqyrtim në kuvend ndonjë akt apo vendim sipas nenit 55.3 të LVL. Komuna nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje me komunat tjera brenda dhe jashtë vendit. Komuna nuk ka lidhur marrëveshje me fshatra apo vendbanime. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur dy mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete nuk ka mbajtur asnjë të vetme. Në këtë komunë ende nuk janë formuar komitete të tjera.

Kuvendit të komunës i është drejtuar një peticion, kurse kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare nga qytetarët nuk ka pasur. Komuna ka të miratuar Rregulloren për përdorim të gjuhëve. Kuvendi i Komunës ende nuk ka formuar komitete konsultative. Vështirësitë në themelimin e komiteteve konsultative jane thjesht të natyrës organizative.

Komuna nuk ka themeluar Këshillin komunal për siguri në bashkësi.

KOMUNA E KLINËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Klinës ka mbajtur tri (3) mbledhje të rregullta. Janë themeluar komitetet e obligueshme të cilat funksionojnë normalisht. Komiteti për Politikë dhe Financa si dhe Komiteti për Komunitete kanë mbajtur nga një mbledhje.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Klinës ka marrë vendim për themelimin e komiteve konsultative, por që ende nuk janë themeluar. Po ashtu, kjo komunë nuk ka të themeluar Këshillin komunal për siguri në bashkësi. Për tre mujorin e këtij viti Komuna e Klinës, ka organizuar një tubim publik me qytetarë. Kuvendi i Komunës ka të miratuar Rregulloren komunale për gjuhët.

Në periudhën janar-mars, Kuvendi i Komunës së Klinës ka miratuar 16 vendime, ndërsa nuk ka miratuar asnjë Rregullore.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Ndërkohë që, ka pasur një kërkesë dhe peticion nga qytetarët drejtuar Kuvendit të Komunës.

Për tremujorin e parë të vitit 2010, Komuna e Klinës nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me komuna tjera, fshatra, vendbanime dhe lagje. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar 16 vendime, ndërsa nuk është miratuar asnjë Rregullore.

Në këtë komunë, gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur ndonjë rast që subjektet politike të mos marrin pjesë në punën e kuvendit komunal. Po ashtu nuk ka pasur raste kur zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, aktet apo vendimet e komunës t'ia paraqes kuvendit për rishqyrtim sipas nenit 55.3 të LVL.

KOMUNA E LIPJANIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka mbajtur 3 (tri) mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme. Kuvendi i komunës është funksional dhe në të marrin pjesë të gjitha subjektet politike rregullisht. Gjatë kësaj periudhe nuk është realizuar asnjë mbledhje e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe e Komitetit për Komunitete, pasi që gjatë kësaj periudhe nuk kanë qenë të themeluara.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Lipjanit nuk ka ngritur komitete konsultative, si dhe komitete të tjera krahas atyre të obligueshme. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është themeluar në vitin 2009, i cili gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 2 mbledhje. Për tre mujorin e këtij viti

Komuna e Lipjanit ka organizuar një tubim publike me qytetarë. Janë miratuar gjithsej gjashtë vendime, ndërsa nuk është miratuar asnjë rregullore. Komuna ka të miratuar Rregulloren për përdorim të gjuhëve.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare apo peticion nga ana e qytetarëve. Komuna e Lipjanit nuk ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me komuna tjera brenda ose jashtë vendit, po ashtu nuk ka lidhur marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje.

Sipas të dhënave që kemi në dispozicion në këtë komunë nuk ka pasur raste kur zëvendëskryesuesi për komunitete ka paraqitur akte apo vendime për rishqyrtim kuvendit të komunës sipas nenit 55.3 të LVL.

KOMUNA E MALISHEVËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka mbajtur tri (3) mbledhje të rregullta dhe një (1) mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej dy (2) mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete nuk ka mbajtur asnjë të vetme.

Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitetet konsultative ashtu siç i parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale, por është themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi i cili gjatë kësaj periudhe ka mbajtur një mbledhje.

Kuvendi i komunës gjatë kësaj periudhe nuk ka mbajtur asnjë tubim publik me qytetarë. Në këtë komunë ende nuk është miratuar Rregullorja për përdorimin e gjuhëve.

Gjatë këtij tremujori të parë, Komuna e Malishevës ka miratuar gjithsej trembëdhjetë (13) Vendime dhe shtatë (7) Rregullore.

Komuna nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me komuna tjera, fshatra, vendbanime apo lagje.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Malishevës për periudhën e raportimit ka pranuar një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, ndërsa kërkesë a peticion drejtuar kuvendit të komunës nuk ka pasur.

Vlen të ceket se në këtë komunë nuk ka pasur raste që ndonjë subjekt politik të mos marr pjesë në punën e Kuvendit Komunal. Gjithashtu nuk ka pasur ndonjë rast që zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, aktet apo vendimet e komunës t'ia paraqes kuvendit për rishqyrtim sipas nenit 55.3 të LVL.

KOMUNA E MAMUSHËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Mamushës ka mbajtur katër (4) mbledhje të rregullta. Është themeluar vetëm Komiteti për Politikë dhe Financa si komitet i obligueshëm, ndërsa Komiteti për Komunitete nuk është themeluar ende.

Në këtë komunë, nuk ka të themeluar, komitetet tjera si komitete konsultative. Kuvendi i Komunës, s'ka mbajtur tubime publike me qytetarë, ndërsa, ka të miratuar rregulloren komunale për gjuhët. Komuna e Mamushës ka miratuar gjithsej njëmbëdhjetë (11) vendime, ndërsa ka miratuar një Rregullore.

Në Komunën e Mamushës është themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi. Gjatë periudhës së raportimit komuna e Mamushës ka lidhur marrëveshje me Komunën e Keçioren- it nga Republika e Turqisë.

Sa i përket qasjes në dokumente zyrtare, kjo Komunë për periudhën e tre mujorit, nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Po ashtu kuvendit të komunës nuk i është drejtuar asnjë peticion.

Në këtë komunë nuk ka pasur raste ku ndonjë nga subjektet politike të mos marrin pjesë në punën e Kuvendit Komunal, apo raste kur zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, aktet apo vendimet e komunës t'ia paraqet kuvendit për rishqyrtim sipas nenit 55.3 të LVL.

KOMUNA E MITROVICËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka mbajtur tri mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar dy mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe një mbledhje të Komitetit për Komunitete. Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Mitrovicës i ka ngritur Komitete Konsultative, si dhe ka themeluar edhe komitete të tjera.

Për periudhën tre mujore të këtij viti Komuna e Mitrovicës nuk ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës nuk ka miratuar asnjë rregullore, por ka miratuar 8 vendime.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare, por ka pasur një peticione nga qytetarët e Komunës. Ky peticion ka të bëjë me kërkesën e qytetarëve për mos privatizimin e objektit "Jadran" si zonë me interes të veçantë të cilin objekt e kishte shpall Kuvendi i Komunës së Mitrovicës në vitin 2007.

Kuvendi i Komunës ka themeluar edhe Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe gjatë kësaj periudhe ka mbajtur tri takime. Po ashtu në këtë

komunë nuk ka pasur raste kur zëvendëskryesuesi për komunitete të ketë paraqitur akte apo vendime kuvendit për rishqyrtim.

KOMUNA E NOVOBËRDËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Kuvendi Komunal i Novobërdës është funksional. Gjithsej ka mbajtur 4 mbledhje. Mbledhja e inauguruese është mbajtur me datë 29.12.2009, ndërsa seanca e parë e rregullt është mbajtur me datë 05.01.2010, seanca e dytë është mbajtur me dat. 04.02.2010 kurse seanca e tretë e rregullt është mbajtur me datë 02.03.2010. Në këtë komunë nuk është mbajtur asnjë mbledhje e jashtëzakonshme. Në mbledhjen e tretë të rregullt opozita ka lëshuar mbledhjen. Kuvendi i komunës deri më tani nuk ka miratuar asnjë rregullore, kurse ka miratuar 3 vendime. Komuna ende nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje me komunat brenda dhe jashtë vendit.

Edhe në këtë komunë nuk është mbajtur tubim publik me qytetarë. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur dy mbledhje, kurse Komiteti për Komunitete ende nuk ka mbajtur mbledhje. Në këtë komunë ende nuk ka komitete tjera të formuara. Po ashtu, nuk janë themeluar ende komitetet konsultative. Këshilli komunal për siguri është i formuar. Rast të peticionit të drejtur Kuvendit apo Ekzekutivit në këtë komunë nuk ka pasur deri më tani. Komuna ka të miratuar Rregulloren për gjuhët. Nuk ka pasur raste kur zëvendëskryesuesi për komunitete të ketë paraqitur akte apo vendime kuvendit për rishqyrtim

KOMUNA E OBILIQIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar - mars 2010, Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë të jashtëzakonshme. Në punën e kuvendit marrin pjesë të gjitha subjektet politike të përfaqësuar në të. Kuvendi i Komunës ka themeluar Komitet e obligueshme. Ende nuk është themeluar ndonjë komitet konsultativ, ashtu siç i parasheh Ligji për vetëqeverisje neni 73, e po ashtu nuk është themeluar asnjë komitet tjetër. Gjatë kësaj periudhe kuvendi i komunës nuk ka mbajtur tubime publike me qytetarë. Nuk është miratuar asnjë rregullore për këtë periudhë, ndërsa janë miratuar gjithsej 14 vendime. Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Obiliqit për periudhën janar-mars 2010 nuk ka pranuar ndonjë kërkesë. Gjithashtu nuk ka pasur asnjë peticion nga qytetarët. Komuna e Obiliqit nuk ka lidhur marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, po ashtu nuk ka pasur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Në komunën e Obiliqit është krijuar Këshilli komunal për siguri në bashkësi. Ky këshill gjatë kësaj periudhe ka mbajtur një mbledhje. Deri më tani nuk ka pasur raste kur zëvendëskryesuesi për komunitete, aktet apo vendimet e komunës t'ia paraqes kuvendit për rishqyrtim

KOMUNA E PEJËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Pejës ka mbajtur tri (3) mbledhje të rregullta. Kuvendi i komunës ka themeluar komitetet e obligueshme, të cilat funksionojnë normalisht. Për këtë periudhë kohore, Komiteti për Politike dhe Financa ka mbajtur një (1) mbledhje, derisa Komiteti për Komunitete nuk ka mbajtur asnjë të vetme.

Në këtë komunë, janë themeluar katër (4) komitete të tjera si komitete këshillëdhënëse por që përbërja në këto komitete është nga subjektet politike. Sipas të dhënave, në këto komitete është i përfshirë përfaqësimi gjinor, por që deri më tani këto komitete nuk kanë raportuar para Kuvendit ashtu siç parashihet në nenin 7.4 të Udhëzimit Administrativ Nr.2008/10. Kuvendi i komunës nuk ka mbajtur tubime publike me qytetarë. Komuna ka të miratuar Rregulloren komunale për gjuhët. Komuna e Pejës ka miratuar gjithsej 27 vendime, ndërsa nuk ka miratuar asnjë Rregullore.

Në këtë komunë është themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi. Gjatë periudhës së raportimit, Komuna e Pejës nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje me komunat tjera, fshatra, vendbanime ose lagje.

Sa i përket qasjes në dokumenteve zyrtare, Komuna e Pejës për periudhën e tre mujorit, nuk ka pranuar ndonjë kërkesë të tillë, si dhe nuk ka pasur asnjë peticion nga qytetarët.

Vlen të ceket se në këtë komunë nuk ka pasur raste ku ndonjë subjekt politik të mos marr pjesë në punën e kuvendit komunal, apo raste kur zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, aktet apo vendimet e komunës t'ia paraqes kuvendit për rishqyrtim sipas nenit 55.3 të LVL.

KOMUNA E PRISHTINËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar - mars 2010, Kuvendi i komunës së Prishtinës, ka mbajtur tri mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme. Kuvendi ka themeluar komitetet e obligueshme. Gjatë kësaj periudhe, Komiteti për Politike dhe Financa ka mbajtur dy mbledhje, kurse Komiteti për Komunitete ka mbajtur dy sosh.

Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitete konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për vetëqeverisje lokale, por janë themeluar katër komitete të tjera. Kuvendi i Komunës, gjatë periudhës tre mujore, nuk ka mbajtur ndonjë tubim publik me qytetarë. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës së kuvendit. Komuna ka të miratuar Rregulloren për gjuhë. Gjatë kësaj periudhe kuvendi i komunës ka miratuar katërbëdhjetë vendime.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Prishtinës për periudhën e tremujore të parë të këtij viti nuk ka pranuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, e po ashtu nuk ka pasur ndonjë peticion nga qytetarët.

Komuna e Prishtinës gjatë kësaj periudhe nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje.

Në komunën e Prishtinës, është krijuar edhe Këshilli komunal për siguri në bashkësi, i cili gjatë këtij tremujori nuk ka mbajtur asnjë mbledhje. Sipas të dhënave që kemi në dispozicion, në këtë komunë nuk ka pasur raste që zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, aktet apo vendimet e komunës t'ia paraqes kuvendit për rishqyrtim sipas nenit 55.3 të LVL.

KOMUNA E PODUJEVËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Podujevës, ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë të jashtëzakonshme. Kuvendi është funksional dhe në mbledhje marrin pjesë rregullisht të gjitha subjekte politike. Komiteti për Politike dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.

Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitetet konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale, mirëpo janë themeluar komitete të tjera krahas atyre të obligueshme.

Kuvendi i komunës nuk ka mbajtur ndonjë tubim publik me qytetarë. Nuk është miratuar rregullorja e punës së kuvendit, gjithashtu nuk është miratuar asnjë rregullore tjetër. Ndërsa janë miratuar gjithsej gjashtë vendime.

Në këtë komunë nuk ka pasur raste kur zëvendëskryesuesi për komunitete t'ia paraqes komunës akte për rishqyrtim. Komuna e Podujevës, për këtë periudhë ka pranuar vetëm një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, kurse nuk ka pranuar asnjë kërkesë apo peticion.

Komuna e Podujevës nuk ka lidhur marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, mirëpo ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera.

Në komunën e Podujevës është krijuar këshilli komunal për siguri në bashkësi. Gjatë kësaj periudhe ky këshill ka mbajtur një mbledhje.

KOMUNA E PRIZRENIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka mbajtur vetëm seancën inauguruese, ndërsa nuk ka themeluar asnjërën nga komitetet obligative.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Prizrenit nuk ka themeluar Komitete Konsultative. Po ashtu kjo komunë nuk ka të themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Për tre mujorin e parë të këtij viti Komuna e Prizrenit nuk ka organizuar tubim publik me qytetarë. Kuvendi i Komunës ka të miratuar Rregulloren Komunale për Gjuhët.

Në periudhën janar-mars, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka miratuar një (1) Vendim, ndërsa nuk ka miratuar asnjë Rregullore.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare.

Për tremujorin e parë të vitit 2010, Komuna e Prizrenit ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera, me fshatra, vendbanime dhe lagje, të cilat janë të karakterit të përgjithshëm.

Deri më tani, nuk ka pasur raste ku ndonjë subjekt politik të mos marr pjesë me rregull në punën e kuvendit të komunës, apo raste kur zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, aktet apo vendimet e komunës t'ia paraqes kuvendit për rishqyrtim sipas nenit 55.3 të LVL.

KOMUNA E RAHOVECIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Kuvendi i Komunës së Rahovecit është funksional dhe deri më tani nuk ka pasur rast që ndonjë subjekt politik të mos marr pjesë në punën e Kuvendit.

Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës ka mbajtur seancën inauguruese dhe 2 seanca të rregullta. Ndërsa, nuk është mbajtur ndonjë seancë e jashtëzakonshme. Po ashtu, nuk është mbajtur asnjë takim publik me qytetarë.

Kuvendi i Komunës ka themeluar Komitetet e përhershme konform nenit 51.1 të LVL-së. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur një mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete nuk ka mbajtur asnjë të tillë.

Kuvendi i Komunës së Rahovecit ende nuk ka themeluar Komitete Konsultative, ashtu siç parashihet në nenin 73. 1 i LVL-së, e po ashtu nuk ka themeluar Komitete tjera (neni 51.2 të LVL-së.)

Për këtë periudhë nuk është miratuar asnjë Rregullore, ndërsa janë miratuar 7 vendime. Komuna ka të aprovuar Rregulloren për përdorim të gjuhëve.

Komuna nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me komuna tjera, qoftë brenda ose jashtë vendit, e po ashtu nuk ka bërë marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje.

Deri më tani nuk është drejtuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Po ashtu, Kuvendit të Komunës nuk i është adresuar asnjë kërkesë dhe peticion. Ekziston Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi me përbërje të vjetër, i cili gjatë kësaj periudhe nuk ka mbajtur asnjë takim.

KOMUNA E SHTIMES

Funksionimi i Kuvendit të Komunës -Kuvendi i komunës së Shtimes është funksional dhe në të marrin pjesë rregullisht të gjitha subjektet politike të përfaqësuara. Kuvendi i komunës gjatë kësaj periudhe ka mbajtur tri mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme. Kuvendi ka themeluar komitete e obligueshme. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej dy mbledhje, kurse Komiteti për Komunitete ka mbajtur një.

Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitete konsultative, për arsye financiare, e gjithashtu nuk janë themeluar komitete të tjera

Kuvendi i Komunës, gjatë kësaj periudhe nuk ka mbajtur asnjë tubim publik me qytetarë. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba. Vendime janë miratuar gjithsej 13.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Shtimes për periudhën tre mujore nuk ka pranuar ndonjë kërkesë të tillë, po ashtu nuk ka pasur asnjë peticion nga qytetarët. Komuna e Shtimes nuk ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me komuna tjera brenda dhe jashtë vendit, fshatra, vendbanime apo lagje.

Në komunën e Shtimes, është themeluar Këshilli komunal për siguri në bashkësi, ndërsa gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 4 takime. Po ashtu në këtë periudhë zëvendëskryesuesi për komunitete nuk ka paraqitur akte apo vendime para kuvendit për rishqyrtim.

KOMUNA E SKENDERAJT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Skenderajt ka mbajtur tri mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar tri mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa, kurse një mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacioneve që ka MAPL komuna e Skenderajt ende nuk ka formuar komitetet konsultative.

Për tre mujorin e këtij viti Komuna e Skenderajt nuk ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka të miratuar Rregulloren për Gjuhët.

Gjatë kësaj periudhe nuk është miratuar ndonjë rregullore, mirëpo dy rregullore kanë kaluar në diskutim publik. Janë miratuar gjithsej 15 vendime.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare, kurse ka pasur një peticion nga qytetarët e komunës për largimin e imamit të xhamisë në fshatin Marinë.

Kjo komunë nuk ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me komunat e tjera brenda vendit dhe jashtë, por ka lidhur marrëveshje me fshatra, vendbanime dhe lagje për bashkëfinancim të projekteve të ndryshme.

Deri më tani nuk ka pasur zëvendëskryesuesi të Kuvendit të Komunës për Komunitete.

KOMUNA E SHTRËPCËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2009, Kuvendi i Komunës së Shtërpcës ka mbajtur 2 mbledhje të rregulltadhe një të jashtëzakonshme. Trupat e kuvendeve të komunës, konkretisht Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për komunitete, kanë mbajtur nga një mbledhje. Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitete konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për vetëqeverisje lokale dhe nuk janë krijuar komitete tjera.

Kuvendi i Komunës në periudhën tre mujore nuk ka mbajtur asnjë tubim publik me qytetarë. Janë miratuar 8 vendime, ndërsa nuk është miratuar asnjë rregullore.

Komuna e Shtërpcës për periudhën e tre mujorit të parë nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare dhe nuk ka pranuar ndonjë peticion nga qytetarët.

Komuna e Shtërpcës nuk ka lidhur marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, por ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me komunën e Ferizajt dhe Komunën e Shtimes. Me këtë marrëveshje, këto dy komuna do ti ndihmojnë komunës së Shtërpcës në hartimin e disa projekteve më rendësi për këtë komunë.

Në komunën e Shtërpcës nuk është krijuar Këshilli komunal për siguri në bashkësi.

Kjo komunë nuk ka pranuar kërkesë nga zëvendës kryesuesi për komunitete lidhur me rishqyrtimin e akteve apo vendimeve.

KOMUNA E SUHAREKËS

Funksionimi i i Kuvendit të Komunës – Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Suharekës ka mbajtur tri (3) mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakonshme. Komuna ka themeluar komitete e obligueshme. Komiteti për Politike dhe Financa ka mbajtur dy mbledhje ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur një.

Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitetet konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale, por është i themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi i cili gjatë kësaj periudhe ka mbajtur një mbledhje.

Kuvendi i Komunës, gjatë kësaj periudhe nuk ka mbajtur tubim publik me qytetarë. Komuna ka të miratuar Rregulloren Komunale për gjuhët.

Gjatë këtij tremujori të parë, Komuna e Suharekës ka miratuar gjithsej katërmbëdhjetë vendime, ndërsa nuk ka miratuar asnjë Rregullore.

Komuna ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me komunën Ada nga shteti Austriak, marrëveshje e cila i përket sferës së bujqësisë.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Suharekës për periudhën e raportimit nuk ka pranuar ndonjë kërkesë të tillë, gjithashtu nuk ka pas kërkesë apo peticion drejtuar Kuvendit të Komunës.

Komuna e Suharekës nuk ka lidhur marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje.

Në këtë Komunë nuk ka pasur raste ku ndonjë subjekt politik të mos marr pjesë në punën e kuvendit, apo raste kur zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, aktet apo vendimet e komunës t'ia paraqes kuvendit për rishqyrtim sipas nenit 55.3 të LVL.

KOMUNA E VITISË

Funksionimi i i Kuvendit të Komunës - Kuvendi i Komunës së Vitisë është funksional. Të gjitha subjektet politike marrin pjesë në mbledhje rregullisht. Mbledhja inauguruese është mbajtur me datë 12.01.2010, seanca e parë e rregullt me datë 20.01.2010, seanca e dyte me datë 05.02.2010 dhe mbledhja e tretë e rregullt është mbajtur me datë 30.03.2010.

Në këtë komunë nuk është mbajtur asnjë mbledhje e jashtëzakonshme. Kuvendi i komunës ka miratuar dy rregullore: Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba, dhe Rregulloren për tatimin mbi pronën e paluajtshme. Janë miratuar gjithsej 6 vendime.

Në këtë komunë ende nuk është emëruar zëvendëskryesuesi për komunitete. Komuna nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje me bashkëpunimi me komunat tjera brenda dhe jashtë vendit. Sa i përket tubimeve publike me qytetarë komuna ende nuk ka organizuar tubim të tillë. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur

gjithsej 3 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete nuk ka mbajtur asnjë. Komitetet tjera janë në fazën e konstituimit. Këshilli komunal për siguri në Bashkësi është themeluar, por nuk ka mbajtur asnjë takim. Në këtë komunë nuk është drejtuar asnjë petition nga qytetarët. KK-ja ka miratuar Rregulloren për Gjuhët.

KOMUNA E VUSHTRRISË

Funksionimi i Kuvendit të Komunë - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka mbajtur tri mbledhje të rregullta, ndërsa nuk ka mbajtur asnjë të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe Komitetit për Politikë e Financa, ka mbajtur tri mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur një.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Vushtrrisë, ka të themeluar tri komiteteve konsultative.

Për këtë tre mujor të këtij viti, Komuna e Vushtrrisë nuk ka organizuar tubime publike me qytetarë. Kjo komunë ka të miratuar Rregulloren komunale për gjuhët. Gjatë kësaj periudhe nuk është miratuar asnjë rregullore, por dy sosh janë qitur në diskutim publik, kurse kanë miratuar 13 vendime.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Gjithashtu nuk ka pasur kërkesa e peticione nga qytetarët e Komunës.

Komuna ka formuar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 3 mbledhje. Në këtë komunë nuk ka zëvendëskryesues për komunitete.

KOMUNA E KLLOKOTIT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Kllokotit ka funksionuar normalisht. Kjo Komunë ka zgjedhur strukturat e larta udhëheqëse duke filluar nga kryetari i Komunës, nënkryetari si dhe nënkryetari i komunës për komunitete. Gjithashtu Komuna e Kllokotit ka zgjedhur kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin për Komunitete. Në këtë periudhë të raportimit Komuna e Kllokotit ka themeluar Komitetet obligative, ndërsa komitete tjera nuk ka themeluar. Në Komunën e Kllokotit është miratuar Rregullorja e Punës dhe nëntë vendime të tjera.

Mbledhjet e mbajtura nga kuvendi i komunës janë transparente. Njoftimi për mbledhje të Kuvendit përgjithësisht bëhet me kohë. Kjo Komunë ka formuar pesë drejtori, prej të cilave njëren prej tyre e udhëheq subjekti politik nga radhët e komunitetit shqiptar.

KOMUNA E RANILLUKUT

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Gjatë periudhës janar-mars 2010, Kuvendi i Komunës së Ranillukut ka funksionuar normalisht dhe ka mbajtur dy mbledhje, një të rregullt dhe një inauguruese. Kjo Komunë ka zgjedhur strukturat e larta udhëheqëse duke filluar nga kryetari i Komunës, nënkryetari, ndërsa nënkryetari i komunës për komunitete nuk është zgjedhur ende. Kjo komunë nuk ka miratuar akoma Statutin - aktin më të lartë të komunës. Gjithashtu Kuvendi i Komunës së Ranillukut ka zgjedhur kryesuesin e kuvendit. Ndërsa zëvendëskryesues ende nuk ka zgjedhur. Njoftimi për mbledhje të kuvendit kryesisht bëhet me kohë. Në këtë Komunë është themeluar Komiteti për Politikë dhe Financa. Komuna ka formuar katër drejtori, një të cilave e udhëheq komuniteti shqiptar. Në periudhën e raportimit është miratuar vetëm “Rregullorja për subvencionimin e qifteve të sapolindura” si dhe “Fëmijët e posalindur”.

KOMUNA E GRAÇANICËS

Funksionimi i Kuvendit të Komunës - Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka mbajtur mbledhjen inauguruese. Prej 19 anëtarëve sa janë gjithsej, 17 anëtarë e kanë dhënë betimin. Në këtë Komunë janë zgjedhur kryetari i komunës, nënkryetari dhe nënkryetari i komunës për komunitete. Po ashtu është zgjedhur kryesuesi i kuvendit dhe zëvendëskryesuesi i kuvendit për komunitete. Kuvendi ka themeluar Komitetet obligative, ndërsa Komitete të tjera nuk janë themeluar akoma. Njoftimi për mbledhje bëhet me kohë. Mbledhjet janë transparente, por që përktimi nuk sigurohet. Në komunën e Graçanicës janë themeluar gjashtë (6) drejtori. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar këto akte: Statuti i Komunës, Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës, Rregullorja në tatimin e Pasurisë së Paluajtshme, po ashtu janë miratuar edhe pesë vendime të tjera.

KOMUNA E LEPOSAVIQIT

Nuk kemi të dhëna

KOMUNA E ZUBIN POTOKUT

Nuk kemi të dhëna

KOMUNA E ZVEQANIT

Nuk kemi të dhëna.

SHKELJET LIGJORE TË KOMUNAVE TË EVIDENCUARA NGA MAPL

Duke u bazuar në mandatin që ka Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, është e obliguar që të bëjë shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve dhe vendimeve të ndërmarra nga komunat.

Në këtë kontekst, gjatë muajve janar-mars, Divizioni i Monitorimit ka evidencuar këto shkelje ligjore:

Komuna e Ferizajt

Ka bërë shkelje të nenit 54 të LVL-së, sepse në mbledhjen inauguruese të mbajtur më datë 28.12.2009, ka zgjedhur zëvendëskryesuesin nga radhët e komunitetit shumicë.

Komuna e Pejës

Në mbledhjen e parë të rregullt të mbajtur më 15.01.2010 ka bërë shkelje të nenit 61.1 të LVL-së. Kryetari i Komunës ka emëruar dy nënkryetarë nga radhët e komunitetit pakicë.

Komuna e Malishevës

Në mbledhjen e mbajtur më 15.01.2010 është shkelur neni 42.5 i LVL- së dhe neni 20.5 i Statutit të komunës së Malishevës. Meqenëse këtë mbledhje është dashur ta udhëheq anëtari më i vjetër i kuvendit, atë e ka udhëhequr kryetari i Komunës.

Komuna e Vitisë

Në mbledhjen e mbajtur më 20.01.2010 ka bërë shkelje të nenit 54 të LVL-së. Kuvendi i Komunës ka zgjedhur zëvendëskryesuesin, mirëpo nga radhët e komunitetit shumicë.

Po ashtu, kjo Komunë ka shkelur edhe Statutin e komunës me rastin e emërimit të drejtorive. Meqenëse me Statut parashihet që komuna të ketë gjashtë drejtori, kryetari i ka themeluar njëmbëdhjetë sosh, pa iu nënshtruar procedurave paraprake të ndryshimit të Statutit.

Komuna e Lipjanit

Në mbledhjen e mbajtur më 26.02.2010 ka bërë shkelje, të nenit 61 të LVL-së me rastin e emërimit të nënkryetarëve. Kryetari ka emëruar dy nënkryetarë, mirëpo nga radhët e komunitetit shumicë.

Gjithashtu është rritur numri i drejtorive komunale, pa ndryshim paraprak të statutit.

Komuna e Pejës

Në mbledhje e mbajtur më 15. 02. 2010 me rastin e rishikimit të procedurës së zgjedhjes së nënkryetarit për komunitete (kërkesë e komunitetit jo shumicë) nuk u zbatua neni 61.3 dhe i LVL-së. Në këtë seancë kandidati i propozuar për nënkryetar, edhe pse nuk ka fituar shumicën e votave të anëtarëve të kuvendit, prapë se prapë është emëruar për këtë pozitë.

Komuna e Skenderaj

Në mbledhjen e mbajtur më 26.02.2010 ka marrur vendim në bazë të peticionit të organizuar nga shoqëria civile për largimin e Hoxhës dhe mbylljen e Xhamisë në fshatin Marinë.

Gjithashtu në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 31.03.2010, ka shkelur Statutin e komunës me rastin e emërimit të drejtorive. Janë shtuar 3 drejtori, pa iu nënshtruar procedurave të ndryshimit të Statutit.

Komuna e Rahovecit

Në mbledhjen e mbajtur më 23.03.2010, ka bërë shkelje e nenit 65 pika 2 e LVL-se. Tre nga drejtorët të cilët janë emëruar nga kryetari dhe të cilët kanë dhënë dorëheqjen me shkrim para kuvendit, vazhdojnë të jenë pjesë e kuvendit në cilësinë e anëtarit duke ushtruar të gjitha të drejtat që i takojnë një anëtar të kuvendit duke përfshirë edhe të drejtën për të votuar.

Po ashtu është bërë shkelje e nenit 60 pika 5 e LVL-së, sepse nënkryetari i komunës vazhdon të jetë edhe anëtar i kuvendit të komunës.

KONKLUZIONE

Duke u bazuar në të dhënat që ka në dispozicion MAPL, për periudhën e tremujorit të parë vitit 2010, japim konkluzionet si vijon:

- Komunat kanë mbajtur numër të mjaftueshëm të seancave të Kuvendeve. Lidhur me këtë, mund të konstatohet se Kuvendet e Komunave të Republikës së Kosovës janë funksionale, me përjashtim të komunës së Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut, të cilat vazhdojnë të mos kenë bashkëpunim me institucionet e Kosovës.
- Jo të gjitha komunat kanë themeluar komitete të tjera, përveç atyre obligative të parapara me LVL..
- Disa komuna ende vazhdojnë të mos e dërgojnë materialin e mbledhjeve me kohë në autoritetin mbikëqyrës, në këtë rast MAPL-së, ashtu siç parasheh neni 43.5 i LVL-së.
- Shumica e komunave nuk respektojnë nenin 80 të LVL-se, i cili i obligon kryetarët e komunave të dërgojnë listën e të gjitha akteve të miratuara nga kryetari dhe kuvendi në muajin paraprak, deri më datën 10 të çdo muaji.

REKOMANDIME

- Komunat sipas nenit 43.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, duhet t'i dërgojë MAPL-së ftesën dhe materialet e mbledhjes, 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.
- Komunat të cilat nuk i kanë themeluar Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi rekomandohen që, ti themelojnë këto këshilla konform Udhëzimit Administrativ 2008/09.
- Komunat të cilat ende nuk i kanë themeluar Komitetet konsultative, gjatë themelimit të tyre të kenë parasysh nenet 73.1 dhe 73.2 sa i përket përbërjes në këto Komitete e cila duhet të jetë nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, e jo nga subjektet politike, po ashtu të kenë parasysh edhe përfaqësimin gjinor në këto Komitete.

- Komunat të cilat kanë rritur numrin e Drejtorive pa respektimin e procedurave ligjore, rekomandohen që fillimisht të ndjekin ato procedura para rritjes së numrit të Drejtorive.
- Rekomandohen komunat që të respektojnë, Nenin 65.2 të Ligjit për vetëqeverisje Lokale, sipas të cilit drejtorët komunal, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civil të administratës së komunës nuk mund të jenë anëtar të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo Kuvendit të Komunës ku ata punojnë.
- Rekomandohen komunat të cilat kanë bërë shkelje ligjore gjatë këtij tre mujori, që të rishqyrtojnë vendimet e tyre, konform kërkesave të MAPL-së.

- Raporti i kompletuar është hartuar nën mbikëqyrjen e Rozafa Ukimeraj, Drejtoreshë e Departamentit për Vetëqeverisje Lokale dhe Xhevat Tafa, udhëheqës i Divizionit për monitorim të Komunave;
- Të dhënat nga Komunitat u mblodhën nga ekipet monitoruese nga Divizionit të Monitorimit të Komunave:
 1. Diellor Gashi;
 2. Gzim Sahiti;
 3. Hamit Fazliu;
 4. Haxhi Krasniqi;
 5. Manushaqe Mucaj;
 6. Zajrete Sylejmani;
 7. Zijadin Biqkaj;
- Për saktësinë e të dhënave të paraqitura në raport janë përgjegjëse Komunitat e Republikës së Kosovës;
- E Drejta autoriale e këtij raporti in takon Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;